

KEDS INFO është fletushkë informative e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Sh.A.

Publikohet nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun.  
pr@keds-energy.com

# KEDS INFO

NR.01 / TETOR / 2013 / FALAS

2 Së bashku do t'i  
faqe përmbushim  
të gjitha objektivat

3 Zgjerohet dhe  
faqe përforcohet  
rrjeti në tërë Kosovën

4 KEDS  
faqe përhap dritë në  
zonat e reja

6 Publikohet  
faqe uebfaqja e  
KEDS

9 Studentët përfituan  
faqe nga praktika në  
KEDS

13 Sabri Fejzullahu  
faqe flet për  
KEDS

# Së bashku do t'i përmbushim të gjitha objektivat



Informatori që ju sot keni në duart e juaja është një përpjekje jona shtesë që ne të jemi më afër juve për të qenë sa më transparent dhe për të çmuar punën e secilit.

Unë jam thellësisht mirënjohës dhe i lumtur që kam rastin të punoj së bashku me Ju për t'i përmbushur objektivat që ia kemi vënë vetes. Puna jonë e përbashkët po kurorëzohet me arritje në të gjitha fushat e veprimit tonë.

Të gjithë parametrat kryesorë të matjes së rezultateve tregojnë se KEDS është kompani e stabilizuar dhe po ecën fuqishëm drejt konsolidimit dhe fuqizimit të mëtutjeshëm.

Është duke u punuar shumë edhe në zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit. Humbjet teknike e komerciale të energjisë elektrike janë zvogëluar dhe KEDS po punon shumë që këto humbje të zvogëlohen edhe më tepër, kurse ato komerciale të shkojnë drejt zeros.

KEDS po bën një luftë të pakompromis ndaj keqpërdorimeve të energjisë elektrike, por puna nuk është kryer ende. Vjedhjet e energjisë elektrike vazhdojnë të jenë të larta dhe kjo është e papranueshme.

Unë jam i bindur se në të ardhmen përmes angazhimit të udhëhequr nga profesionalizmi dhe vendosmëria juaj, çdo objektiv e vënë është e realizueshme. Mbetem edhe më tej tërësisht i angazhuar për punë të përbashkët për të arritur suksese të reja që do të rezultojnë në shërbime cilësore për konsumatorët tanë dhe ngritje të mirëqenies së punonjësve tanë.

Sfidë në vete paraqet sezoni i dimrit që është në prag, kur dukshëm rriten kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve për konsum sa më të madh të energjisë elektrike. Kjo sfidë vë para nesh objektiva të reja të punës që kërkojnë angazhim edhe më të madh dhe më cilësor nga të gjithë ne, e që rezultojnë në ngritje të mëtutjeshme të cilësisë së shërbimeve të kompanisë karshi konsumatorit, obligim i ynë i marrë që qytetarit t'i sigurojmë dritën e merituar, cilësore dhe të pandërprerë.

Gjatë kësaj periudhe të ekzistencës dhe të qenit aktiv kemi dëshmuar disa herë që në raste emergjente, falë mobilizimit dhe përkushtimit tonë të vazhdueshëm, bashkërisht i tejkalojmë sfidat në afat të shkurtë kohor, e gjitha kjo me qëllim që konsumatorët tonë të kenë vazhdueshëm energji elektrike.

Kontributi i secilit prej nesh është vendimtar për të ardhmen e kompanisë, të ardhmen e vendit dhe të ardhmen tuaj. Ne kemi shumë për të bërë. Tejkalimi i sfidave dhe arritja e objektivave realizohen vetëm atëherë kur të gjithë bashkërisht fokusohemi në to. Distribuimin e energjisë elektrike do ta shndërrojmë në linjën më profesionale të ofrimit të shërbimeve në Kosovë dhe përfundimisht, do të mburremi me vendet tona të punës.

Si ndërmarrje, jemi të hapur për sugjerime, vërejtje dhe për idetë tuaja dhe ju premtojmë që ato do të merren parasysh.

Lutemi të besoni në vizionin tonë dhe na përkrahni në përmbushjen e qëllimeve tona. Jemi të bindur që bashkërisht të pamundurën ta bëjmë të mundur.

Sinqerisht i juaji,  
**Vedi YEŞİLKILIÇ**



## Zgjerohet dhe përforcohet rrjeti në tërë Kosovën

KEDS ka filluar investimet në rrjetin e distribucionit, ku disa projekte janë duke u implementuar që nga transferimi i rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike të KEDS. Kjo kompani është duke implementuar shumë projekte me qëllim stabilizimin e distribucionit dhe rrjetit të furnizimit dhe të shpërndarjes së energjise elektrike në gjithë Kosovën, thotë Avni Alidemaj, Drejtor Ekzekutiv i Divizionit të Shpërndarjes.

Kompania KEDS do të investojë një shumë prej 110 milionë euro në 5 vitet e ardhshme dhe një shumë prej më shumë se 300 milionë euro në periudhën 15- vjeçare.

Momentalisht, 7 projekte janë duke u implementuar në rrjetin e tensionit të mesëm derisa 20 janë duke u implementuar në rrjetin e tensionit të ulët. Këto projekte do të kontribuojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë së furnizimit lokal, performancës dhe do të zvogëlojnë humbjet teknike.

Kemi filluar me implementimin e disa projekteve në fazat fillestare. Disa nga këto projekte janë inicuar nga kompania e mëparshme dhe janë jetësuar nga KEDS, thotë Alidemaj

Me qëllim të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë Kosovën, nga ana e KEDS ka filluar rehabilitimi dhe fuqizimi i rrjetit, ku është duke u implementuar në të gjitha shtatë distriktet dhe përbëhet prej ndërrimit të linjave dhe shtyllave të 0.4 kV dhe 10 kV dhe transformatorëve 10/0.4 kV. Me fjalë tjera, projektet përfshijnë përmirësimin e rrjetit të tensionit të ulët dhe atij të lartë”, thotë Alidemaj.

Me qëllim të përmirësimit të rrjetit të distribucionit dhe furnizimit me energji elektrike dhe me qëllim të zvogëlim-it të humbjeve teknike dhe humbjeve komerciale, jemi të përkushtuar për të implementuar planin tonë të investimeve. Lusim të gjithë qytetarët dhe konsumatorët për durim dhe besim në KEDS dhe besojmë që gjatë implementimit të projekteve tona shumë shpejt çdo pjesë e Kosovës do të ndriçohet, deklaroi Alidemaj.

Infrastruktura momentale e trashëguar është e vjetër dhe nuk mund t'i bëjë ballë presionit nga kërkesat e konsumatorëve. Infrastruktura e trashëguar është e përbërë me pajisje më të vjetra se 40 vjet dhe si pasojë kemi disa raste me dëgjje të transformatorëve, kryesisht për shkak të moshës dhe nga ngarkesa e madhe. Jemi duke u përballur me shumë probleme në mirëmbajtjen e rrjetit të distribuimit dhe furnizimit me energji elektrike. Jemi të përkushtuar dhe të motivuar plotësisht nga burimi ynë i energjisë – konsumatorët tonë për të vazhduar me zëvendësimin e këtyre pajisjeve të vjetra. Besojmë që ndryshimet radikale nuk ndodhin brenda ditës, andaj lusim të gjithë konsumatorët për durim”, thotë ai.

Projekt që ia vlen të përmendet është përmirësimi dhe instalimi i rrjetit në zonën që përfshin të ashtuquajturën Prishtina e Re, e njohur si zonë potenciale për ndërtimin e ndërtesave dhe lagjeve të reja, si dhe sipas planifikimit urban, zonë që do të shërbejë për ndërtimin e ndërtesave administrative qeveritare. Projekti pritet të përfundojë në mars të vitit të ardhshëm dhe të gjitha ndërtesat do të ndriçohen nga nënstacioni i ri Prishtina 7, i vendosur në pjesën e Veternikut.

Projekti ka për qëllim të ndërtojë lidhje të reja kablore të tensionit të mesëm 10 (20) / kV nga nënstacioni Prishtina 7. Kemi pranuar lejen nga Komuna e Prishtinës në qershor të këtij viti dhe kemi filluar me punët e ndërtimit me kontraktues të jashtëm nga Shqipëria – Enbi Power. Ndërmarrja është duke punuar me ekipe të ndryshme në katër segmente. Projekti është në vlerë prej 1.7 milion euro dhe pritet të përfundojë në afat kohor prej 283 ditësh, thotë ai.

Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), është shoqëri aksionare me operim në tërë territorin e Kosovës dhe ka ekskluzivitetin e furnizimit me energji elektrike dhe shpërndarjes së saj. KEDS është pronë e kompanive prestigjioze turke Çalık Holding dhe Limak.



## KEDS përhap dritë në zonat e reja

Me zgjerimin e zonave të banuara, është rritur edhe numri i konsumatorëve në amvisëri dhe atyre komercial për furnizim me energji elektrike, ku kapacitetet aktuale nuk mund të sigurojnë sasi të mjaftueshme energjetike.

Marrë parasysh planifikimin me kohë dhe ndërtimin e Nënstacionit të Ri 110/10(20) kV Prishtina 7, zona që përfshin Prishtinën e Re, që njihet si zonë potenciale e zhvillimit dhe ndërtimeve të reja, ku sipas planit të ri urbanistik pritet të kalojnë shumë objekte të reja qeveritare, do të kenë mundësinë të furnizohen pa probleme duke qenë se në implementim është projekti i daljeve 10(20) kV, që pritet të përfundojë deri në mars të vitit 2014. Ndërtimet e reja do të marrin dritë nga Nënstacioni i ri Prishtina 7, që ndodhet në lagjen e Veternikut.

Puna në projektin e Daljeve Kablore të tensionit të mesëm 10(20) kV nga NS 110/10(20) kV Prishtina 7, ka filluar në qershor të këtij viti nga kompania e re për distribuimin dhe furnizimin me energji elektrike në Kosovë - KEDS.

Kontrata është nënshkruar nga fundi viti 2012 nga KEK-u dhe e njëjta i është transferuar KEDS-it. KEDS ka siguruar Lejen e Ndërtimit nga Komuna e Prishtinës në qershor të këtij viti dhe kontraktori nga Shqipëria, ENBI Power, menjëherë ka nisur punimet dhe është duke punuar me katër ekiye paralelisht në katër segmente. Ky projekt kap shifrën rreth 1,7 milionë euro dhe pritet të përfundojë me një afat kohor prej 283 ditësh. Për definimin e tasave të Linjave Kablore 10(20) kV, KEDS ka koordinuar me Komunën e Prishtinës, e cila ka përfunduar punët e planit urbanistik për këtë zonë.

Projekti është duke u realizuar në koordinim me të gjitha palët, komunën, policinë dhe ministrinë përkatëse, andaj punët janë duke ecur mbarë. Nën mbikëqyrjen e stafit të KEDS-it, të udhëhequr nga Leonora Hysenaj, menaxhere e këtij projekti, punët janë duke shkuar sipas planifikimit të paraparë. Edhe pse ka pasur disa probleme të vogla në terren, që kanë të bëjnë me çështjet pronësore, deri më tani këto probleme janë zgjidhur dhe puna nuk ka ngecur.

Projekti pritet të përfundojë deri në mars të vitit të ardhshëm dhe sipas planifikimit deri në fund të këtij viti pritet të energjizohen së paku 7 dalje 10(20) kV. Me realizimin e këtij projekti jo vetëm ndërtimet dhe objektet e reja, por edhe konsumatorët aktual do të kenë furnizim më kualitativ dhe më të sigurt me energji elektrike, si dhe do të zvogëlohen humbjet teknike dhe do të shkarkohen nga ngarkesa NS 110/10(20) kV Prishtina 2; NS 110/10(20) kV Prishtina 3 dhe nënstationet 35 kV ( Prishtina II, Prishtina III dhe Badovci) që aktualisht furnizojnë konsumatorët e kësaj zone.

Drejtori Ekzekutiv i Divizionit të Shpërndarjes në KEDS z. Avni Alidemaj, potencoi se puna nuk do të ndalet. KEDS do të investojë në mënyrë që konsumatorët të kenë një furnizim të sigurt dhe kualitativ me energji elektrike, gjithashtu KEDS do të bëjë riaktualizimin e disa projekteve të tjera që kanë qenë bashkëinvestime me kuvendet komunale dhe disa kompani private, por që janë ndërprerë.



# Qasje e shpejtë, efektive dhe cilësore për konsumatorët



Përpilimi i politikës dhe procedurës së re të kutive të sugjerimit, duke përfshirë edhe formularët e rinj të sugjerimit nëpër secilin distrikt dhe nëndistrikt, ku konsumatorët e jashtëm dhe të brendshëm mund të komunikojnë me KEDS për të dhënë komentet e tyre pozitive dhe ato negative lidhur me cilësinë e shërbimeve tona, do t'i ndihmojnë KEDS të bëjë përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve.

Lidhur me aktivitetet që po zhvillohen në Departamentin për Shërbim ndaj Konsumatorëve në nivelin qendror të KEDS, biseduam me menaxherin e këtij departamenti, Ilir Dula. Ai tha se, që nga ndërrimi i pronësisë, një ndër prioritetet më të rëndësishme të ndërrmarjes së re KEDS, është arritja dhe ofrimi i shërbimit të shpejtë, efektiv dhe kualitativ për konsumatorët dhe në këtë linjë është edhe përkushtimi i punëtorëve të këtij departamenti në nivelin qendror. Për të arritur këtë qëllim, ky departament është orientuar në krijimin e shërbimeve të reja për konsumatorët, përpilimin e procedurave të reja, ndryshimin dhe përshtatjen e procedurave të mëhereshme, inicimin dhe krijimin e praktikave më të mira të punës për punëtorët në këtë departament dhe të punëtorëve të Shërbimit ndaj Konsumatorëve nëpër distrikte dhe nëndistrikte, në veçanti, si dhe trajnimin e këtyre punëtorëve sipas standardeve të orientuara nga konsumatori.

Në këtë aspekt, vazhdoi Dula, brenda kësaj periudhe kohore Departamentin për Shërbim ndaj Konsumatorëve në nivelin qendror ka inicuar dhe realizuar këto aktivitete: Përpilimi i politikës dhe procedurës së re të kutive të sugjerimit dhe vendosjen e kutive të reja të sugjerimit, duke përfshirë edhe formularët e rinj të sugjerimit nëpër secilin distrikt dhe nëndistrikt, ku konsumatorët e jashtëm dhe të brendshëm mund të komunikojnë me KEDS për të dhënë komentet e tyre pozitive dhe ato negative lidhur me kualitetin e shërbimeve tona, e të cilat komente do t'i ndihmojnë KEDS të bëjë

përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve.

Implementimi i programit të CCRMS (Sistemi i menaxhimit të kërkesave dhe ankesave të punëtorëve) nëpër distrikte dhe nëndistrikte, përmirësimi i vazhdueshëm i programit për të ofruar procesimin digjital, më të shpejtë dhe në kohë reale të të gjitha kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve, duke mënjanuar metodën e vjetër të regjistrimit manual. Me këtë program iu mundësohet konsumatorëve që të drejtohen vetëm te sporteli për Shërbim ndaj Konsumatorëve, që do të luajë rolin e një pike kontakti për të kryer të gjitha shërbimet që ata i kërkojnë në KEDS. Më tej, ai tha se, gjatë kësaj periudhe kohore, nga ana e këtij departamenti, është bërë trajnimi i punëtorëve në nivel të kompanisë, ku edhe është planifikuar që nga data 1 nëntor 2013, ky program të hyjë në fuqi edhe zyrtarisht. Integrimi i Qendrës së Thirrjeve të Furnizimit dhe të Rrjetit në një qendër thirrëse profesionale dhe të efektshme, e cila përmes dy numrave të telefonit 038 501 701 100 dhe 038 791 000 dhe e-mailit [contactcenter@keds-energy.com](mailto:contactcenter@keds-energy.com) ofron shërbim të drejtëpërdrejtë për konsumatorët 24/7 për të gjitha kërkesat, ankesat, prishjet në rrjet, sugjerime etj. Po ashtu, nga ana e këtij departamenti, është bërë trajnimi i punëtorëve për të marrë njohuri rreth të gjitha shërbimeve të ofruara.

Me iniciativën e Departamentin për Shërbim ndaj Konsumatorëve në nivelin qendror dhe me udhëzimin e Menaxhmentit të KEDS, është bërë formimi i ekipeve të negociimit me konsumatorët komercialë, për të negociuar dhe parandaluar vonesat në pagesat e rregullta të faturave dhe në këshillimin e këtyre konsumatorëve për pasojat ligjore në rast të mospagesës me kohë të faturave. Për t'u mundësuar konsumatorëve qasje më të lehtë në parashkrimin e kërkesave, ankesave, sugjerimeve dhe komenteve të tyre, ky departament ka ideuar formimin e një komunikimi digjital dhe të drejtëpërdrejtë me konsumatorët, duke lënë në dispozicion të konsumatorëve kutinë e sugjerimeve online në fushën IDEJA JUAJ në faqen elektronike të KEDS, tha Dula.

Ky departament ka përpiluar edhe udhëzimin për ripërtëritjen dhe rritjen e numrit të konsumatorëve me kontrata për furnizim me energji elektrike dhe në të njëjtën kohë ka filluar lidhja e kontratave, fillimisht me konsumatorët komercial dhe industrial, e më vonë edhe me konsumatorët shtëpiak. Qëllimi kryesor i këtij veprimi është që në një afat relativisht të shkurtër, të gjithë konsumatorët të kenë kontratat për furnizim me energji elektrike. Gjithashtu, është bërë dorëzimi i certifikatave dhe letrat e referencës për 21 studentët, të cilët kanë përfunduar me sukses programin gjashtëmuor të internshipit në KEDS.

Gjatë kësaj periudhe kohore ky departament ka organizuar trajnimin e punëtorëve (të rekomanduar nga distriktet) për kompletimin e lëndëve dhe korrigjim financiar të faturave jo të rregullta. Trajnimi është mbajtur prej 23 shtator deri më 3 tetor 2013, ku janë trajnuar 7 punëtorë në Qendrën e Trajnimit në Kastriot, nga trajnerët Hysni Gashi dhe Muharrem Surdulli. Në fund të trajnimit është bërë dorëzimi i certifikatave për pjesëmarrje në trajnim.

# Publikohet uebfaqja e KEDS

“Kompania kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike” ka publikuar faqen e vet në internet [www.keds-energy.com](http://www.keds-energy.com). Uebfaqja ka për qëllim t’u ofrojë qasje konsumatorëve duke u ofruar informata dhe shërbime të rëndësishme. Faqja është publikuar në muajin tetor 2013.

KEDS ka përgatitur një faqe interaktive dhe shumë të lehtë për qasje, në të cilën qytetarët e Kosovës do të jenë në gjendje jo vetëm të marrin informata për furnizimin me energji elektrike, por edhe të njoftohen për shërbime të rëndësishme për ta. Po ashtu, është për t’u vlerësuar fakti se përmes uebfaqes edhe informimi i mediave të shkruara dhe elektronike do të jetë më i shpejtë dhe më efikas. Nëpërmjet uebfaqes mediat do të marrin informata lidhur me ndërprerjet e planifikuara të rrjetit, intervenimet emergjente, furnizimin me energji elektrike, si dhe do të informohen edhe për projektet dhe aktivitetet që do të zhvillohen në vazhdimësi.

Konsumatorët do të jenë në gjendje që përmes uebfaqes të informohen për gjendjen e faturës së tyre. Njëherësh, për herë të parë konsumatorëve do t’u ofrohen shërbime online. Ata përmes fushës IDEJA JUAJ do të mund të bëjnë kërkesa, sugjerime apo ankesa online. Nëpërmjet faqes së internetit, konsumatorët do të mund t’i adresojnë kërkesat për lidhje të reja, për ndërrim pronari, për rikyçje e të ngjashme. Pra, një familje që e ka pasur të pasivizuar njëhisorin e energjisë elektrike për shkak se jeton jashtë Kosovës, nga cilido qytet në botë mund të bëjë kërkesën për rikyçje dhe kjo kërkesë do të trajtohet njësoj sikur kërkesat e parashtruara në sportelet e KEDS.


Konsumatorët do të mund të parashtrojnë edhe ankesat nëpërmjet faqes në internet.



Këto do të trajtohen dhe do të procesohen nga zyrtarët e KEDS njëjtë sikurse të parashtroheshin në sportelet e KEDS. Naxhije Arifaj, përgjegjëse për publikime dhe uebfaqe në Zyrën për Komunikime në KEDS, u shpreh e kënaqur që KEDS ka arritur kaq shpejt të hapet për konsumatorët, duke u ofruar një faqe interneti me numrin më të madh të shërbimeve që ofron ndonjë kompani në rajon.

Në kuadër të këtij angazhimi, KEDS do të ndërtojë një marrëdhënie sa më të afërt, sa më profesionale dhe sa më transparente me shfrytëzuesit e shërbimeve të kompanisë. Me këtë synohet që qytetari të jetë sa më mirë i informuar për të arriturat e kompanisë, për sfidat me të cilët përballet kompania, si dhe me zgjidhjet që i ndërmerr kompania. Duke informuar drejt dhe shpejt KEDS dëshiron që konsumatorin ta bëjë partner dhe rruga e zhvillimit të KEDS të bëhet edhe rrugë e zhvillimit të qytetarit të Kosovës. Ky projekt do të ndihmojë përgjithësisht në ngritjen e transparencës dhe informimit me kohë të konsumatorëve, mediave dhe palëve të treta.”, deklaroi ajo gjatë prezantimit të uebfaqes.

Ndërkaq, Ilir Dula, menaxher i DSHK, tha: “Në mënyrë që të mos mblidhen sugjerimet nga konsumatorët vetëm personalisht, kutia e sugjerimeve online të fusha IDEJA JUAJ është përfshirë në faqen elektronike të KEDS-it, ashtu që konsumatorët, punëtorët dhe pjesa tjetër e audiencës mund të arrijë KEDS-in në çdo kohë dhe kudo. Kutia e sugjerimeve online ju jep mundësinë konsumatorëve dhe punëtorëve që të përmirësojnë shërbimet e kompanisë përmes kontributit të tyre digjital. Të dhënat e pranuar nga IDEJA JUAJ do të transferohen në Departamentin për Shërbim ndaj Konsumatorëve për procesin e trajtimit të rregullt dhe të mëtejshëm”.



# Leximi i njehsorëve bëhet përmes pajisjeve elektronike të dorës

Me ardhjen e Konsorciumit të ri i cili ka privatizuar Distribucionin (KEDS), është ndier nevoja për ndërrimin e disa funksioneve të deritanishme. Njëra ndër kërkesat ishte edhe ndryshimi për leximin e konsumatorëve përmes metodës së re të leximit 20-ditor. Kjo metodë parashihet leximet e konsumatorëve me pajisje elektronike të dorës (Handheld Unit) HHU, fillon bisedën Agron Kamberi, drejtor regjional në KEDS. Fillimisht nga ZRRE është marrë miratimi për të filluar një test në Distriktin e Ferizajit, i cili test do të prezantohet para ZRRE për aprovim të mëtutjeshëm për gjitha distriktet. Me leximin e ri përfshihet leximi i konsumatorit dhe shtypja e faturës menjëherë pas leximit të njehsorit përmes pajisjes HHU në formë elektronike, që ka qasje direkte - online me sistemin e faturimit. Kjo formë e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tariforë e zëvendëson metodën e deritanishme të leximit në formë manuale. Leximi i njehsorëve të konsumatorëve tariforë përmes metodës aktuale ka filluar në fund të secilit muaj dhe ka përfunduar në fillim të muajit në vazhdim, cikël që ka zgjatur 3+1 ditë, ndërsa me sistemin e ri, leximi parashihet të jetë 20 ditë pune, ku lexuesi i njëjtë do të lexojë ditën e njëjtë të çdo muaji, duke përfshijtur vikendet dhe festat zyrtare, ku konsumatori do të ketë mundësinë që në prani të lexuesit të KEDS të shikojë menjëherë shpenzimin mujor dhe të marrë faturën për energjinë e shpenzuar elektrike.

Divizioni i Furnizimit ka bërë përgatitjet për të rregulluar sistemin, në mënyrë që të fillojë testimin në Distriktin e Ferizajit. Përgatitja ka përfshirë blerjen e pajisjeve, adaptimin e programit për lexim me pajisjen e dorës, vendosjen e stafit, përgatitjen e manualit për stafin, i cili do ta përdorë pajisjen, trajnimin e stafit, planifikimin ditor të leximit dhe numrin e konsumatorëve për lexim ditor, thotë Kamberi. Aplikimi i kësaj metode, nënkupton saktësi dhe korrektesë në të dhënat e regjistruara në njehsorët elektrik, si dhe informata në kohë reale lidhur me shpenzimet e energjisë për secilin konsumator.

Metoda përfshin leximin me pajisjen e dorës HHU (pajisjen elektronike të dorës për leximin e gjendjeve të njehsorit elektrik dhe shtypjen e faturës së konsumatorit), metodë e cila minimizon në maksimum çdo gabim eventual në lidhje me shpenzimin e energjisë elektrike gjatë leximit. Leximi testues me

këto pajisje në terren është në koordinim të plotë dhe i aprovuar nga ZRRE. Kjo formë e re e leximit përfshin leximin e energjisë së shpenzuar elektrike në datën e caktuar të secilit muaj, shtypjen dhe dorëzimin e faturës konsumatorit për konsumin mujor të energjisë elektrike në momentin e leximit të njehsorit elektrik dhe mundësinë e korigjimit aty për aty, në rast se vërtetohet pasaktësia në lexim. Ky sistemi i ri mundëson mbikëqyrje në çdo moment të aktiviteteve të leximit në kohë reale.

Në vazhdim, Kamberi thotë se, me fillimin e aplikimit të kësaj teknologjie, do të ketë edhe ndryshime në kohën e leximit, si dhe ndryshime në dizajnin e faturës. Në muajin e parë të leximit konsumatorët do të faturohen për kohë të ndryshme të shpenzimit të energjisë, në mënyrë që të bëhet edhe prerja kohore e llogaritjes së shpenzimit, ku varësisht prej planifikimit të leximit për grupe të konsumatorëve, faturat do të jenë në suaza të kufijve të lejuar të shpenzimit mujor. Pas muajit të parë të aplikimit të leximit përmes HHU, thotë ai, leximi i njehsorëve do të përfshijë periudhën njëmuajore të shpenzimit të energjisë. Data e leximit të çdo konsumatori do të jetë e njëjtë si e leximit paraprak, maksimum dy ditë pune. Në rast se data e leximit dhe toleranca e lejuar prej dy ditësh i bie të jetë në fund të javës ose gjatë festave shtetërore, atëherë periudha kohore e shpenzimit të energjisë elektrike mund të shkurtrohet ose të zgjatet për aq sa zgjasin këto festa.

Nëse konsumatori nuk mundëson qasjen në leximin e njehsorit elektrik, që gjendet brenda, ku lexuesi nuk ka qasje te konsumatori për dy muaj me radhë të ciklit të leximit dhe faturimit, lexuesi do të raportojë, me ç'rast konsumatori merr njoftimin për pamundësinë e leximit të rregullit. Nëse nuk ofrohet qasje për lexim të njehsorit, do të pasojë shkyçja e këtyre konsumatorëve nga rrjeti elektrik për shkak të pamundësisë së leximit. Secili konsumator me rastin e vizitës-leximit të njehsorit elektrik, do t'i shtypet fatura në të njëjtën kohë për energjinë e shpenzuar. Faturimi i konsumatorëve do të bëhet sipas sistemit tarifor të aprovuar nga ZRRE. Pas testimit në Ferizaj, prezantimit në Zyrën e Rregullatorit dhe aprovimin e dokumenteve të dërguara nga KEDS, leximi ditor në faza do të shtrihet në tërë Kosovën, përfundon Kamberi.





## Punëtorët e muajit

### Valmir Bërbatovci Divizioni i Furnizimit

“ Konsumatori është mbret për mua”, kështu, thotë Valmir Bërbatovci, djaloshi t'mparement, i cili u qaset punëve me vullnet dhe sfidon çdo pengesë në detyrën e tij, e sukseset nuk mungojnë. Tri vite të plota bëhen që ushtrij profesionin specialist i daljes në Distriktin e Prishtinës, thotë Valmiri. Ai ka të përfunduar Shkollën e Mesme Teknike dhe e do këtë profesion. Pasi marrim urdhëresat e mëngjesit nga eprori, vazhdon ai, bashkë me kolegun dhe shokun tim Hamdiun, ia mësojmë lagjes së Veternikut, dhe përveç kësaj lagje, puna jonë shtrihet edhe në lagjet e Çagllavicës, Llapnasellën, Preocin, që kryesisht janë të banuara nga konsumatorët serbë. Lirisht them që me konsumatorët kemi raporte të mira. Një ndër objektivat tona është edhe vetëdijesimi dhe qasja ndaj konsumatorëve për të bindur që të paguajë energjinë e shpenzuar elektrike.

Shkyçja, leximi, rikyçja, kontrollimi i njehsorëve, faturimi i energjisë elektrike, janë punët që në bëjmë çdo ditë. Numri i konsumatorëve që trajtojmë brenda ditës është 25, dhe jemi të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme të punës. Por, ajo që më vë në siklet, është shkyçja e konsumatorëve borxhlinj, punë që më duhet ta zbatoj pa dëshirën time, por më duhet ta kryej detyrën, ku shpesh hasim edhe në vështirësi, sepse ekziston edhe kategoria tjetër e konsumatorëve, atyre të pandërgjegjshëm, thotë Valmiri.

Një ndjenë veçantë e kaplon atë në fund të orarit, ajo e suksesit dhe kur merr vlerësimet më të mira për punën nga përgjegjësit e tij. Ai shpesh është shpërblyer për punën e tij, kështu muajin e fundit ka marrë plus 20 për qind të shumës të pagës.

Për Valmirin stimulimet dhe bonuset, që marrin punëtorët për arritjen e objektivave dhe që vlerësohen në bazë të performancës të mirë në punë, janë një arsye, janë një shtytje për punë më efikase dhe të suksesshme.

### Shaqir Demiri

#### Divizioni i Shpërndarjes

Një mesoburrë, shtatllartë, i heshtur, këto janë vetitë që të lënë përshtypjen e parë të Shaqir Demirit, electricist i matjeve në KEDS. Por ajo që e përmbush dhe cilëson personalitetin e këtij punëtori, është puna që ai bënë, ku i atribuohet vetëm sukseset.

Ky është një shembull për të gjithë, e veçanërisht për punëtorët më të rinj, që Shaqiri ua mëson punën dhe ua lë përvojën amanet.

Shaqir Demiri, electricist i matjeve, ushtron këtë profesion si është më së miri. Ai bënë matjen e energjisë elektrike në mënyrë gjysmë-indirekte te konsumatorët komercial. Është kjo një punë që kërkon përgjegjësi, ku rreziku ekziston gjithmonë, pasi që matjet bëhen edhe në trafostacione të tensionit 10/kW. Përafërsisht në çdo 3 muaj bëjmë kontrollin e këtyre njehsorëve dhe numri i konsumatorëve që trajtojmë mbërrin deri në 1000 konsumatorë brenda një viti në Distriktin e Prishtinës, thotë Demiri.

Gjatë punës nuk hasin në probleme të mëdha dhe kur ata shfaqen me qasjen serioze dhe në bashkëpunimin me kolegët ia dalin t'i evitojnë dhe puna vazhdon.

Raportet me konsumatorët i kemi shumë të mira, natyrisht kjo varet nga qasja jonë korrekte ndaj tyre. Reagimet më të mëdha të konsumatorëve më së shumti janë gjatë kohës së reduktimeve të energjisë elektrike, edhe pse ne nuk jemi përgjegjës për këto reduktime, por jemi të parët që jemi në kontakt me ta”, thotë ai.

“ E dua këtë profesion, andaj i qasem me vullnet e përkushtim të madh” dhe kënaqësia më e madhe është, kur përvojën time ua përcjell punëtorëve të rinj dhe ata i akceptojnë porositë e mia, sepse ky profesion, përveç pjesës teorike, kërkon përpikëri edhe në anën praktike”, thotë Demiri.







## Studentët përfituan nga praktika në KEDS

Studentët përveç që morën njohuri nga praktika, ata përfituan edhe të mira materiale, paga në vlerë prej 75 % të pagës së nëpunësit të Departamentit për Përkujdesje ndaj Konsumatorëve. Këto të mira materiale u mundësuan atyre që t'i mbulojnë shpenzimet e studentëve së paku për një vit.

Në shtator të këtij viti, KEDS ndau 21 certifikata për përfundim të suksesshëm të internshipeve (punës praktike) për këta studentë nga universitetet dhe bartësit tjerë të akredituar të arsimit të lartë në Kosovë. Me anë të këtij programi studentët kanë bërë punë praktike në departamente të ndryshme të KEDS, me qëllim të ngritjes së aftësive praktike në punë dhe me qëllim të parapërgatitjes për tregun e punës.

Me gjithë problemet në gjetjen e vendeve të punës dhe me numrin e madh të papunësisë, internshipet (puna praktike) janë dëshmuar si të qenit mënyrë e mirë për përfitimin e njohurive relevante,

aftësive dhe përvojës duke themeluar lidhje të ndryshme në praktikë. Internshipet në KEDS ofrojnë njohuri dhe përvojë në praktikë me qëllim të përgatitjes së studentëve dhe të posa-diplomuarve për tregun e punës. Studentët e diplomuar me internshipe të përfunduara në rezyretë e tyre kanë mundësi më të madhe në gjetjen e pozitave dhe vendeve të punës pas diplomimit dhe besojmë që puna praktike do të ndihmojë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik të Republikës së Kosovës.


Përfundimisht, mendojmë se të gjithë studentët mund të ofrojnë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e ndërmarrjeve duke ofruar ide dhe zgjidhje të përfituara gjatë studimeve në institucione të arsimit të lartë në Kosovë. Për më shumë, KEDS do të vazhdojë bashkëpunimin me studentë, institucione të arsimit të lartë dhe institucione tjera vendore në ofrimin e mundësive të internshipeve me qëllim të kontribuimit në zhvillimin e tregut të punës dhe në mënyrë indirekte, zhvillimin

e gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit.

“Puna si intern (praktikant) në Qendrën e Thirrjeve të KEDS ka shërbyer si mundësi shumë e mirë që si student të fitojë përvojë pune dhe të vazhdojë studimet njëkohësisht. KEDS është ndër ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë dhe njohuria e fituar në Qendrën e Thirrjeve dhe në departamente tjera të KEDS do të më ndihmojë në të ardhmen për punësim të mëtutjeshëm. Referencat e fituara dhe aftësia e zhvilluar në punë ekipore kanë ndihmuar në zhvillimin tim personal dhe në përgatitje për tregun e punës.” – thotë Agon Ibrahim, një ndër praktikantët e certifikuar.

Për fund, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë studentët dhe institucionet e arsimit të lartë për bashkëpunimin dhe shpresojmë që bashkëpunimi të vazhdojë me qëllim të avancimit të jetës akademike në Kosovë dhe zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik.

# Ibrahimi i 'përqafuar' me shtyllën bie përtokë



## Punëtori që pa vdekjen me sy

Të gjithë kanë një tregim. Ibrahim i ka të vetin. Duke koordinuar punët me kolegët dhe eprorët, ai ia ka dalë mbanë, më mirë se të gjithë madje. Për të dita nisën në ora 6 të mëngjesit. Ngrihet nga shtrati, përgatitet dhe del me pi një kafe. Pak para orës 8 ai është në zyrat e Distriktit të Ferizajit, aty ku punon. Detyrat shpërndahen para orës 8. Në 8 e 5 minuta të gjithë punëtorët janë në terren. Atë fundmuaj korriku Ibrahim Delolli, së bashku me kolegët e tij, ia mësyen fshatit Gaçkë për ta riparuar rrjetin e vjetër.

Por, për Ibrahimin, ajo ditë më vapë e muajit korrik mund të ishte fatale, po siç thotë ai, 'falë Zotit' shpëtoi pa ndonjë pasojë të madhe. Kjo ngjarje aksidentale ndodhi në fshatin Gaçkë të Ferizajit, gjatë ndërrimit të një shtylle të rrjetit elektrik për të zëvendësuar me një të re. Pas u ngjiti në shtyllë, nuk kaluan disa minuta, ai u gjet i shtrirë bashkë me të në asfalt, ku pëson lëndime të rënda trupore ( në kokë, krahë, brinj e pjesë të tjera). Me vrap kolegët e kapin dhe e dërgojnë në Qendrën Emergjente, prej nga, me të marrë ndihmën e parë, e transferojnë në QKUK në Prishtinë. Pas analizave dhe përkujdesjes intensive mjekësore, dërgohet në shtëpi për mjekim dhe shërim të mëtutjeshëm.

Ibrahimi 26-vjeçar, ka tre vjet që bën punën e elektrikistit në mirëmbajtjen e rrjetit elektrik në këtë distrikt dhe gjithnjë, edhe pse i lënduar dhe i lodhur nga incidenti, edhe pse me një dëgjim paksa të dobësuar, si pasojë e rënies, ai flet me një buzëqeshje dhe plotë krenari për stafin e vet të dëshmuar

dhe për rezultatet e arritura në punë.

"Puna jonë është shumë e vështirë, sepse kemi të bëjmë me mirëmbajtjen e rrjetit të energjisë elektrike në këtë rajon. Jemi një shërbim mjaft homogjen dhe kjo më bën të ndihem shumë i lumtur që gjendem me një ekip që detyrat i kryen me vullnet.

Asnjëherë nuk jam dorëzuar para stuhive, por përkundrazi, jam shumë i përkushtuar në punë me qëllim që të kontribuoj për kompaninë, shpeshherë duke kaluar edhe tërë orarin e punës në terren. Këtë punë do ta bëj me një përkushtim edhe më të madh në të ardhmen".



Në pyetjen tonë ai përgjigjet: "Po more, na shajnë përditë. Por, punëtorët e kanë të ngulitur në kokën e tyre se duhet të sillen korrekt me konsumatorët, pavarësisht reagimit të tyre. Konsumatori është mbret", konstaton Delolli.

Të vetmin mesazh për punëtorët e KEDS që ai ka është: "Respektojeni punën, pa punë nuk arrihet asgjë".

## Post Mortum

### Mexhid Hyseni

Me indinjatë të thellë kemi marrë lajmin e hidhur për vdekjen e kolegut tonë të zellshëm, Mexhid Hyseni. Lajmi për vdekjen e tij, për punëtorët e KEDS ishte më shumë sesa një kumt i dhimbshëm. Vdekja e hershme e Mexhidit është një humbje e madhe për familjen, kolegët e punës, për miqtë dhe për të gjithë ata që e njohën.

I ndjeri është lindur më 18.03.1954 në Firajë të Shtërpcës. Ka punuar në Distriktin e Ferizajit, përkatësisht në Nëndistiktin e Shtërpcës prej vitit 2000, si elektrikist i rrejtë, kurse prej vitit 2009 ka qenë udhëheqës i ekipit për mirëmbajtje. Më 19.09.2013 ndahet nga jeta në vendin e punës në fshatin Sevcë, duke punuar në shtyllë sipas kërkesës zyrtare të eporit. Vdekja ka qenë krejtësisht e natyrshme, e jo pasojë e ndonjë lëndimi në punë.



Mexhidi ishte personifikim i korrektësisë, dashurisë, profesionalizmit, miqësisë dhe njerëzisë. Familja e tij mbeti pa më të dashurin e vet, ndërsa në kolegët e tij mbetëm pa një ekspert dhe një bashkëpunëtor të vyeshëm. Portreti dhe figura e tij gjithnjë karakterizojnë profilin e një punëtori të ndërgjegjshëm, të prindit, vëllait dhe mikut të dashur.

Këtë dhimbje duhet ta shoqërojë krenaria me të cilën duhet të mburren familja, miqtë, shokët dhe të gjithë ata me të cilët punoi Mexhidi.

Këshillat dhe sugjerimet e tij për punë profesionale përherë do të mbesin udhërrëfytes për ne dhe për punëtorët e KEDS përgjithësisht.

Ju, më të dashurit e Mexhidit, patët një djalë, vëlla, baba dhe bashkëshort të urtë e shembullor, bujar dhe të afërt për të gjithë. Gjatë gjithë jetës le t'ju udhëheqë kujtimi i pavdekshëm për virtytet e tij të larta!

# Ftesë për bashkëpunim

## Të nderuar lexues!

Filluam me publikimin e numrit të parë të gazetës në kompaninë e re KEDS. Që sot e tutje do të jemi bashkë, sepse kemi nevojë edhe për ndihmën tuaj.

Departamenti për Komunikime në KEDS në vazhdimësi është duke bërë përpjekje që informimin ta bëjë sa më të mirë, më atraktiv, më të besueshëm dhe më të lexueshëm.

Qëllimi i stafit të këtij departamenti është informimi sa më korrekt për rrjedhat në KEDS dhe rreth tij.

Fizionomia e qartë dhe informimi korrekt e bëjnë të mundshëm informimin e brendshëm e të jashtëm, që është me rëndësi të veçantë.

Departamenti jonë është mënyra më e lehtë për të komunikuar me punëtorët e KEDS për të gjitha çështjet që janë në interes të tyre.

Natyrisht, për neve mendimi juaj është mjaft i vlefshëm për temat, problemet dhe çështjet që duhet t'i trajtojmë, çfarë duhet të ndryshojmë, të shtojmë apo të heqim. Cilat rubrika i preferoni ju.

Pra, në vazhdimësi ju thërrasim të na kontaktoni në çfarëdo forme, nëpërmjet postës elektronike, telefonit apo drejtpërsëdrejti në zyrën e redaksisë sonë.

Me një përkujdesje të veçantë do t'i trajtojmë të gjitha propozimet dhe sugjerimet tuaja që janë në interes të informimit të drejtë.

Ju faleminderit për bashkëpunim.  
Redaksia



Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A.

Kosovsko Produzece.za Distribuciju i Snaabdevanje Elektricnom Energijom D.D

Kosovo Electricity Distribution and Supply Company J.S.C

## NJOFTIM

Të nderuar konsumatorë,  
KEDS ju njofton se për të gjitha pyetjet për:

- Faturën
- Prishjet në rrjet,
- Denoncim
- Informacione të përgjithshme
- Pyetje tjera

Ju lutem të thirrni në  
Call Center

038 501 701 1000 ose 038 79 1000

## OBAVEŠTENJE

Poštovani potrošači,  
KEDS vas obaveštava da za sva pitanja o:

- Računu
- Kvarovi na mreži,
- Prijave
- Opšte Informacije
- Ostala pitanja

Molimo vas pozovite na  
Call Center

038 501 701 1000 ili 038 79 1000

## ANNOUNCEMENT

Dear Customers,  
KEDS informs you that for all the questions regarding:

- Bill
- Network failures
- Denounce
- General Information
- Other questions

Please call at  
Call Center

038 501 701 1000 or 038 79 1000

# Sabri Fejzullahu flet për KEDS



Se si një njeri i njohur i estradës e akcepton rëndësinë e energjisë elektrike, biseduam me Sabri Fejzullahun, këngëtar

## **- Si e përdorni ju energjinë elektrike?**

Dihet që energjia elektrike është shtyllë e ekonomisë dhe e domosdoshme dhe si çdo konsumator edhe unë e përdori mjaft. Por më duhet t'ju them, se në lagjen ku banoj unë, Bërnice e Ulët, shpesh ndalet rryma , por ne kemi mundësi dhe gjejmë alternativë tjetër për ngrohje, përdorim drutë dhe naftën. E dimë që Kosova është shumë e pasur me thëngjill dhe mendojmë se edhe furnizimi me energji elektrike duhet të jetë sa më i mirë.

## **- A është obligim pagesa e energjisë elektrike?**

Dihet që çdo mall i harxhuar duhet të paguhet. Nuk ndodh askund në botë që shfrytëzimi i energjisë elektrike të bëhet pa pagesë, pos te ne ndodh kjo. Jo vetëm obligim, por pagesa e energjisë elektrike është obligim edhe moral, njerëzor dhe ndihmë për ndërtimin e shtetit.

## **- Sa i kushtoni rëndësi eficiencës së energjisë elektrike?**

Patjetër që i kushtoj rëndësi. Në vend që të harxhoj 100 V , unë përdori poçat 20 V që kursejnë energjinë elektrike, por njëkohësisht edhe xhepin tonë. Më rastis shpesh të shoh në shtëpi të ndryshme dritat ndezur në pikë të ditës. Duhet ta kursejmë atë. Madje, të kursesh energjinë elektrike është kulturë.

## **-A jeni të kënaqur me furnizimin me energji elektrike?**

Po e theksoj edhe njëherë, në lagjen ku unë banoj, nuk kemi furnizim të rregullt me energji elektrike. Brenda javës , tani këto ditë ndodh që të kemi ndërprerje të rrymës nga 5-6 orë në ditë.

Nuk e di sa është e ndershme, që ne që paguajmë energjinë elektrike të pësojmë për shkak të atyre që s'paguajnë në lagjen time. Por shpresoj se tani me ardhjen e kompanisë së re do të ndërmarrin masa për të përmirësuar situatën energjetike.

## **-Çfarë përshtypje keni për kompaninë e re KEDS?**

Është shumë herët të flas për KEDS për këtu te ne në Kosovë. Kurse në vende tjera kompania Çalik Limak njihet si eksperte e sektorit energjetik dhe shumë e suksesshme. Sa kam lexuar unë KEDS pritet të investojë një shumë rreth 300 milionë euro dhe jam i bindur që do të jemi në nivel siç është Evropa, se energjia elektrike i takon civilizimit.

## **- Kush e bënë pagesën e energjisë elektrike në familjen tuaj?**

Gjithnjë ajo që mban shtëpinë, ajo që rritë dhe edukon fëmijët , ajo që udhëheq ekonominë- pra, gruaja ime.

## ÇALIK Holding

ÇALIK Holding është krijuar në vitin 1981 nga Ahmet Çalik, pjesëtar i familjes Çalik, të cilët kanë filluar aktivitetet komerciale qysh në vitet e 1930-ta. Sot, Grupi ka të punësuar rreth 20, 000 punëtorë në të gjitha njësitë biznesore, të shpërndara në 17 vende, në sektorët: energjia, telekomi, tekstili, ndërtimi, financat, mediat dhe minierat.

Si një nga kompanitë më të mëdha industriale në Turqi, Çalik Holding vazhdon të jetë në mesin e investitorëve liderë turk në Lindjen e Mesme dhe në Ballkan, dhe ka një qarkullim prej 2.8 miliardë dollarësh amerikanë. Me asetë të konsoliduara prej 8 miliardë dollarësh, Çalik Holding aktualisht është duke punuar në projektet në vlerë prej 20 miliardë dollarë.

Çalik Holding është një faktor i rëndësishëm në sektorin e energjisë. Kompania është zgjeruar në këtë sektor dhe tashmë ka në kuadër të saj edhe kompanitë Yeşilirmak Elektrik Dağıtım YEDAŞ, që furnizon me energji elektrike pesë qytete të rëndësishme në Turqi dhe Kompaninë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS). Çalik Holding është e përfshirë edhe në aktivitete tjera të shumta energjetike, si brenda Turqisë ashtu edhe në vende tjera, si renovimi i infrastrukturës elektrike në një pjesë të Turkmenistanit, stabilizimi i centralit elektrik nga gazi në Gjeorgji dhe termocentralit Navol në Uzbekistan.

### *Investimet në energji të Çalik Holding*

- Çalik Enerji si pjesë e Çalik Holding, ka nënshkruar kontratë në vlerë prej 200 milionë dollarësh amerikanë për të ndërtuar centralin e parë të kombinuar në Gjeorgji.
- Çalik Enerji këtë vit do të fillojë me modernizimin e centralit të kombinuar me gaz natyror në Turkmenistan me kapacitet prej 750 MW.
- Çalik Enerji ka përfunduar tash 80% të punimeve në ndërtimin e termocentraleve Al Khairat dhe Nainawa në Irak me kapacitet prej 2000 MW.
- Çalik Enerji ka fituar tenderin dhe ka në bashkëpronësi Kompaninë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), që ka mbi 450 mijë konsumatorë dhe shpërndan mbi 5 miliardë kWh energji elektrike në vit.

## LIMAK Holding

LIMAK Holding është krijuar në vitin 1976. Gjatë zhvillimit kjo kompani është zgjeruar dhe zhvillon aktivitetet e saj në disa sektorë, duke përfshirë energjinë, turizmin, cementin, infrastrukturën, menaxhimin dhe operimin e aeroporteve, menaxhimin e porteve, si dhe sektorët e ushqimit dhe aviacionit.

Limak Construction ka kompletuar me sukses të plotë shumë projekte me vlerë të përgjithshme prej më shumë se 6 miliardë dollarë amerikanë, duke përfshirë aeroporte, porte, autostrada, hidrocentrale, fabrika industriale, tubacione të naftës dhe gazit, komplekse ndërtesash dhe hotelesh. Njëherësh është në mesin e kompanive ndërtuese më të mëdha ndërkombëtare të listuara nga revista Engineering News Record.

Një nga degët e kompanisë është edhe Limak Energy Group, që është aktive në tërë zinxhirin energjetik, duke përfshirë prodhimin, distribuimin, shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike. Në targetet e saj strategjike, Limak Energy Group vazhdon të zhvillojë projekte të reja, me qëllim që të arrijë 5000 megavatë kapacitete prodhuese. Aktualisht, Limak Energy prodhon me 5 hidrocentrale, ndërsa deri në vitin 2014 kompania synon të lëshojë në prodhim edhe tri hidrocentrale të tjera. Kompania është bërë lidere në treg për shpërndarjen e energjisë elektrike, duke fituar tenderët për privatizimin e kompanive distribuese Bogazici dhe Akdeniz në Turqi dhe Kompaninë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike në Kosovë. Limak është i përfshirë në një gamë të gjerë të aktiviteteve energjetike.

### ***Aktivitetet në gjenerim të energjisë elektrike:***

- Hidrocentrali Alkumru në lumin Dicle-Botan në Sirte me kapacitete të instaluara prej 266 MW dhe kapacitet vjetor të prodhimit prej mbi 1000 GWh.
- Hidrocentrali Uzunçayır në lumin Munzur në Tunceli me kapacitet prej 84 MW dhe kapacitet vjetor prej 322 GWh.
- Hidrocentrali Seyrantepe Dam në rrjedhën Peri të lumit Firat në Elaziğ me kapacitet të plotë të instaluar prej 59 MW dhe kapacitet vjetor prej 164 GWh.
- Hidrocentrali Pamuk në rrjedhën Pamuk në Mersin, me një kapacitet prej 24 MW dhe kapacitet vjetor të prodhimit prej 94 GWh.
- Hidrocentrali Çal në kufinj të e provincës Denizli me kapacitet prej 2.2 MW dhe prodhim vjetor prej 12 GWh.
- Termocentrali gjeotermal Buharkent me kapacitet prej 15 MW dhe kapacitet vjetor prej 110 GWh.

Limak ka në ndërtim e sipër edhe disa hidrocentrale, si: Pembelik me kapacitet prej 130 MW dhe kapacitet vjetor prej 405 GWh, Tatar me kapacitet prej 131 MW dhe kapacitet vjetor prej 421 GWh, Kirazlık me kapacitet prej 45 MW dhe kapacitet vjetor prej 150 GWh, si dhe ka fituar tenderin për privatizimin e termocentralit me gaz natyror Hamitabat, me kapacitete operative prej 1156 MW dhe si pjesë e investimeve, Limak parasheh ta transformojë këtë termocentral më eficientin në Turqi.

### ***Shpërndarja e energjisë***

Limak është aksonar në disa rrjete distributive:

- UEDAŞ merret me shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të energjisë elektrike në provincat Bursa, Balıkesir, Çanakkale and Yalova. Ka 2.7 milionë konsumatorë dhe shpërndan 10 miliardë kWh. Limak ka në pronësi 33% të aksioneve.
- ÇEDAŞ merret me shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të energjisë elektrike në provincat Yozgat, Sivas and Tokat dhe ka 725 mijë konsumatorë dhe shpërndan 3 miliardë kWh. Limak ka në pronësi 33% të aksioneve.
- BEDAŞ merret me shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të energjisë elektrike në pjesën evropiane të Stambollit. Gjithsej ka 4.3 milionë konsumatorë dhe shpërndan 25 miliardë kWh. Limak ka në pronësi 33% të aksioneve.
- AEDAŞ merret me shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të energjisë elektrike në provincat e Antalia, Isparta dhe Budur. Ka 1.7 milionë konsumatorë dhe shpërndan 7.5 miliardë kWh. Limak ka në pronësi 33% të aksioneve.
- KEDS merret me shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë. Ka 450 mijë konsumatorë dhe shpërndan 5 miliardë kWh. Limak ka në pronësi 50 të aksioneve.



Kompania Kosovare për Distribuim dhe  
Furnizim me Energji Elektrike Sh.A.

Kosovsko Produzece za Distribuciju i Snabdevanje  
Elektricnom Energijom D.D

Kosovo Electricity Distribution and Supply  
Company J.S.C



**Burimi i energjisë jeni ju.**

Vi ste izvor energije.

The source of energy is you.

Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), është shoqëri aksionare me operim në tërë territorin e Kosovës. KEDS sh.a. ka ekskluzivitetin e furnizimit me energji elektrike dhe shpërndarjes së saj. KEDS sh.a. është themeluar në vitin 2009, ndërsa ka filluar aktivitetet e saj operative më 8 maj 2013, kur është ndarë përfundimisht nga KEK sh.a.

KEDS sh.a. është pronë e kompanive prestigjioze turke Çalik Holding dhe Limak. Ky konzorcium kishte ofertuar me çmimin më të lartë në tenderin e hapur për privatizimin e ish- Distribucionit të KEK-ut.

KEDS sh.a. ka 2,631 punëtorë duke qenë një nga punëdhënësit më të mëdhenj në Kosovë.